



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 370/prot
14

Tiranë, më 05 . 07 .2018

NJOFTIM

SHPLLJE PUBLIKE VENDIMI

Nr. 2/2018 (JD) datë 21.06.2018

Për ankuesit : **Znj. Rovena Gashi**
Z. Dritan Gina
Adresa: Rruga: Qemal Stafa,
Ndërtesa nr.2, shkalla nr. 3,
Apartamenti nr. 79, Tiranë

Në zbatim të nenin 133/b të Kodit të Procedurës Civile, bëhet “Njoftim me shpallje publike” i vendimit Nr. 2/2018 (JD) datë 21.06.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket ankuesve Znj. Rovena Gashi dhe Z. Dritan Gina.

Ky njoftim së bashku me vendimin do të qëndrojë i afishuar për jo me pak se **20 ditë**, në këndin e Njoftimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të botohet në rubrikën “Shpallje” në faqen zyrtare në internet në adresën: <http://www.kpa.al/shpallje>

Shpallja është afishuar sot më dt. 05/07 2018

(Emër Mbiemër)
(Nënshkrimi)

(*Elton La Ismaj*)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 2/2018(JD)
Datë 17.05.2018

Nr. vendimi 2/2018 (JD)
Datë 21.06.2018

V E N D I M

PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE

Kolegji i shqyrtimit paraprak të ankesës, i përbërë nga:

Ina Rama	Gjyqtare
Luan Daci	Gjyqtar
Rezarta Schuetz	Gjyqtare

sot, më datë 21.06.2018, në Tiranë, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen si më poshtë:

Ankues: Rovena Gashi, me detyrë Prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë
Dritan Gina, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Objekti: 1) Anulimin, si të paligjshëm, të vendimit nr. 140, datë 11.05.2018 të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme Arta Marku, “Për pezullimin nga detyra të Prokurores Rovena Gashi në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, deri në përfundimin e hetimeve ose të gjykimit të procedimit penal 577/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2) Anulimin, si të paligjshëm, të vendimit nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme Arta Marku, “Për pezullimin nga detyra të Prokurorit Dritan Gina në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në përfundimin e hetimeve ose të gjykimit të procedimit penal 577/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

3) Pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 140, datë 11.05.2018 dhe vendimit nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme Arta Marku, deri në përfundim të shqyrtimit me vendim të formës së prerë të ankimit të bërë nga ana e prokurorëve Rovena Gashi dhe Dritan Gina ndaj këtyre urdhrave të paligjshëm.

Baza ligjore: Neni nenin 179 pika 7, dhe neni 148/d pika 4 germa “b” e Kushtetutës, neni 5 pika 3 e ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”, neno 31, 31/a dhe 71/a të ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i ndryshuar; ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kolegji i shqyrtimit paraprak të ankimit (më poshtë referuar si “Kolegji”), pasi dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, shqyrtoi paraprakisht ankimin e paraqitur prej ankuesve, aktet shoqëruese të tij, si edhe analizoi bazën ligjore mbi të cilën mbështet aktivitetin e tij Kolegji i Posaçëm i Apelit në shqyrtimin e rasteve të Juridiksionit Disiplinor,

V Ë R E N:

I

- 1.1 Ndaj ankueses Rovena Gashi, Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme Arta Marku ka nxjerrë urdhrin nr. 140, datë 11.05.2018, “Për pezullimin nga detyra të Prokurores Rovena Gashi në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë Tiranë, deri në përfundimin e hetimeve ose të gjykimit të procedimit penal 577/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.
- 1.2 Ndaj ankuesit Dritan Gina, Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme Arta Marku ka nxjerrë urdhrin nr. 141, datë 11.05.2018, “Për pezullimin nga detyra të Prokurorit Dritan Gina në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në përfundimin e hetimeve ose të gjykimit të procedimit penal 577/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- 1.3 Referuar përmbajtjes së këtyre urdhrave, ato janë marrë nga Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm pasi, me anë të shkresës nr. 2459 datë 08.05.2018 të Prokurorisë së pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është vënë në dijeni se nga ana e kësaj prokurorie, më datë 03.04.2018 është regjistruar procedimi penal nr. 577 në ngarkim të shtetasve Rovena Gashi me detyrë Prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë dhe Dritan Gina me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, për veprën penale “*Refuzim për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram*”, në formën e deklaramit të rremë, parashikuar nga neni 257/a-2 i “Kodit penal”.
- 1.4 Në urdhrat për pezullim nr. 140 dhe nr. 141, në pjesën arsyetuese argumentohet: “Në nenin 151, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet: “*Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur [...] b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje*” dhe se vepra penale e parashikuar nga neni 257/a-2 i “Kodit penal” është krim i rëndë dhe kryer me dashje për shkak të rëndësisë së posaçme të marrëdhënies juridike që cenohet, si dhe subjektit të veprës penale”.
- 1.5 Në vetë përmbajtjen, pjesën argumentuese të urdhrave nr. 140 dhe nr. 141 parashtrohet se këto urdhra janë marrë nga Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm bazuar në nenin 160 të ligjit nr.

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili në pikën 2, germa “c” e tij përcakton: “...Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj: [...] c) pezullon prokurorët, sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj [...]”.

1.6 Në pjesën urdhëruese, urdhrat e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm nr. 140 dhe nr. 141, datë 11.05.2018 parashikojnë: pezullimin nga detyra të znj. Rovena Gashi, prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe të z. Dritan Gina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, deri në përfundim të hetimeve ose të gjykimit të procedimit penal nr. 577/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; njohjen e prokurorëve të pezulluar, Rovena Gashi dhe Dritan Gina, me këto vendime. Në pikën 5 të dispozitivit të secilit vendim parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

II

2. Ankuesit Rovena Gashi dhe Dritan Gina i janë drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit me ankimin e protokolluar me nr. 370 prot., datë 17.05.2018 në të cilin kërkojnë anulim si të paligjshëm të vendimeve nr. 140 dhe nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme Arta Marku, si dhe pezullimin e zbatimit të këtyre urdhrave deri në përfundim të shqyrtimit me vendim të formës së prerë të ankimit të bërë nga ana e prokurorëve Rovena Gashi dhe Dritan Gina ndaj këtyre urdhrave të paligjshëm, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

2.1 Prokurorët Rovena Gashi dhe Dritan Gina nuk janë mbajtës të cilësisë së të pandehurit; vepra penale që u atribuohet dy ankuesve nuk është një krim i rëndë; vepra penale që u atribuohet dy ankuesve, Rovena Gashi dhe Dritan Gina, nuk mund të prezumohet se është kryer me dashje.

III

Vlerësimi i Kolegjit

3. Në vlerësim të situatës, e cila duhet të verifikohet paraprakisht në këtë çështje, Kolegji çmon të shtrojë për diskutim e të analizojë çështjet e mëposhtme.

3.1 Përcaktimi i bazës ligjore të zbatueshme për sa i përket procedurës dhe formës së gjykimit të rasteve të regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelit në kuadër të Juridiksionit Disiplinor.

3.2 Verifikimi i kritereve të shqyrtimit paraprak në lidhje me ankesën e paraqitur prej ankuesve, objekt i këtij gjykimi.

3.1.1 Në lidhje me çështjen e parë, Kolegji konstaton se Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është një juridiksion kushtetues i cili do të shoqërojë veprimtarinë e kësaj trupe përgjatë gjithë mandatit të tij 9- (nëntë) vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës: *“Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”*.

Në vijim dhe në zbatim të këtij parashikimi kushtetues, ligji specifik nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5, pika 3, parashikon:

“[...] Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë:

a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

b) *ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”*.

3.1.2 Parashikimi i nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, i përcakton Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bazën ligjore sipas së cilës ai do të funksionojë dhe do të procedojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues që lidhet me Juridiksionin Disiplinor, i cili rregullohet veçmas dhe specifikisht krahasuar me Juridiksionin e Rivlerësimit. Sipas asaj që parashikon neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelimit do të mbështetë veprimtarinë e tij gjatë ushtrimit të Juridiksionit Disiplinor në:

a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

b) ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”;

c) legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Për shkak të këtij parashikimi, Kolegji vlerëson se procedura e shqyrtimit të të gjitha ankesave apo kërkesave të paraqitura e të regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në kuadër të Juridiksionit të tij Disiplinor, të parashikuar nga Kushtetuta, do të gjykohen në zbatim të normave të ligjit për “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, për sa i përket natyrës e procedurës së gjykimit, duke e konsideruar atë si një gjykim kushtetues, të ndryshëm për nga natyra me gjykimin që Kolegji i Posaçëm i Apelimit bën në rastet kur ai

gjykon sipas Juridiksionit të tij Rivlerësues, gjykim i cili ka tiparet e një procesi që ndërthur natyrën administrative me elementet kushtetuese.

3.1.3 Në këto kushte, Kolegji i shqyrtimit paraprak të ankesës, objekt i këtij gjykimi, do të ndjekë në këtë proces zbatimin e nenit 31 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, sipas përcaktimeve të të cilit gjykimit kushtetues të një çështjeje në seancë plenare i paraprin shqyrtimi paraprak i kërkesë/ankesës nga një kolegji i shqyrtimit paraprak në të cilin bën pjesë edhe relatori i çështjes.

Ky kolegji verifikon paraprakisht kriteret e përgjithshme të parashikuara në nenet 31 e 31/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, si edhe kriteret e posaçme të parashikuara në nenet 71 dhe 71/a të po këtij ligji që lidhen me shqyrtimin e ankimit individual. Verifikimi i këtyre kritereve konsiderohet prej këtij Kolegji si hapi i parë që duhet të ndërmerret para se çështja e Juridiksionit Disiplinor t’i nënshtrohet një gjykimi në themel të cilin duhet ta kryejë seanca plenare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, e përbërë nga të gjithë gjyqtarët e saj.

3.2.1 Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje që konsiston pikërisht në kompetencën për verifikimin e kushteve të parashikuara në nenet 31, 31/a, 71 e 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, Kolegji konstaton situatën ligjore dhe faktike si më poshtë:

3.2.2 Urdhrat nr. 140 dhe nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm për pezullimet nga detyra të prokurores Rovena Gashit dhe prokurorit Dritan Gina, janë marrë bazuar në kompetencat transitore të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm, të përcaktuara në nenin 160 të emërtuar “Organet kompetente për periudhën kalimtare” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar me vendimin e GJK nr. 34, 10.04.2017), i cili në pikën 2 të tij parashikon:

[...] *Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj: [...]*

c) pezullon prokurorët, sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj.

3.2.3 Lidhur me referencën ligjore të aplikuar nga Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm për përmbajtjen e urdhrave nr. 140 dhe nr. 141, datë 11.05.2018 rezulton se ai referon në nenin 151 “Pezullimi i detyruar” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon:

1. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur: [...]

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

2. Pezullimi, sipas pikës 1 të këtij neni, zgjat:

- a) gjatë periudhës së arrestit në burg ose arrestit në shtëpi, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “a”, të këtij neni;
- b) deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “b” të këtij neni.

Rregullimi që bën neni 151 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rrjedh nga përcaktimi kushtetues i nenit 148/d, pika 4, germa “b” e Kushtetutës që parashikon:

1. *Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.*
2. *Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:*
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. *Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.*
4. ***Prokurori pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur:***
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale;
 - b) ***ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;***
 - c) *fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.*

Për sa më sipër, Kolegji konstaton se Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm, ndaj ankuesve, ka urdhëruar pezullimin nga detyra, në zbatim të pezullimit të detyruar, të parashikuar nga neni 148/4, germa “b” e Kushtetutës, si edhe neni 151/1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3.2.4 Nga analiza që u bëhet dispozitave të tjera të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se neni 105 i këtij ligji, rendit llojet e masave disiplinore të cilat aplikohen nga këshillat në përfundim të një procedimi disiplinor. Sipas këtij parashikimi, ato janë: a) *vërejtje konfidenciale*; b) *vërejtje publike*; c) *ulje e përkohshme e pagës*; ç) *ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër*; d) *pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave*; dh) *shkarkim nga detyra*.

Ndërsa neni 110 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i titulluar “Pezullimi si masë disiplinore”, i cili zberthen më tej pezullimin nga detyra si masë disiplinore përcakton: “Masa e pezullimit nga detyra e magjistratit, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, jepet vetëm në këto raste: a) kur shkelja është e shumë e rëndë; b) kur Këshilli çmon se,

pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar”.

3.2.5 Duke krahasuar dy institutet e pezullimit që njih dhe parashikon ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se Këshillat mund të vendosin pezullimin nga detyra të një magjistrati në tri raste:

- Kur pezullimi vendoset si masë disiplinore në përfundim të një procedimi disiplinor të nisur në zbatim të nenit 105 e 110 të ligjit nr. 96/2016.
- Kur aplikohet pezullimi i detyruar, i cili është jashtë dhe në mënyrë autonome nga një procedim disiplinor, që jepet për shkak dhe në funksion të një procedimi penal, si një masë e përkohshme sigurimi në drejtim të substancës së saj, por i bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit.
- Gjithashtu, potencialisht, Kushtetuta në nenin 148/4, germa “c” njih edhe pezullimin diskrecional, i cili aktualisht nuk gjendet i rregulluar në ligj për shkak të shfuqizimit që Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.34 datë 10.04.2017, i bëri nenit 152 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3.2.6 Në çështjen objekt gjykimi, konstatohet se pezullimi i vendosur ndaj prokurorëve Rovena Gashi e Dritan Gina nuk është ai i parashikuar nga nenet 105 e 110 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pra nuk është pezullimi si një masë disiplinore. Në këtë rast, gjendemi para pezullimit të detyruar nga detyra si një masë e përkohshme që vendoset ndaj magjistratit, deri në përfundimin e çështjes penale, për shkak të zbatimit të nenit 151 të ligjit nr. 96/2016.

Ndaj ankuesve nuk rezulton të ketë nisur asnjë procedim disiplinor që mund të përfundohej si procedurë me dhënien e masës disiplinore të pezullimit nga detyra sipas neneve 105 e 110 të ligjit nr. 96/2016. Pezullimi nga detyra i prokurorëve Rovena Gashi dhe Dritan Gina rezulton të jetë urdhëruar prej Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm, në zbatim të institutit të pezullimit të detyruar të lidhur ekskluzivisht me procesin penal që ka nisur në ngarkim të tyre.

3.2.7 Kolegji analizoi edhe dispozitat ligjore që rregullojnë kompetencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në drejtim të shqyrtimit të një ankimi, i cili ngrihet kundër një akti që urdhëron pezullimin e detyruar të magjistratit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 148/d, pika 3 parashikon shprehimisht se kundër vendimit të shkarkimit të prokurorit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese/Kolegjin e Posaçëm të Apelit gjatë periudhës transitorë 9- (nëntë) vjeçare.

Ky parashikim kushtetues është zgjeruar më tej me miratimin e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke i shtrirë garancitë

për shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese e vendit, edhe për masat e tjera disiplinore që japin Këshillat në përfundim të një procedimi disiplinor.

Neni 147/1 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon: “*Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente*”; ndërsa neni 192/1 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon: “*Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese*”.

3.2.8 Në analizë të këtyre dy dispozitave, arrijmë në konkluzionin se me gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankimeve të magjistratit/prokurorit, në rastin e marrjes ndaj tij të masave disiplinore nga këshilli, është Gjykata Kushtetuese. Në vijim të këtij arsytimi, në zbatim të nenit 5, pika 3 e ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon: “[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese*” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e **masave disiplinore** ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.” - arrihet në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit do të jetë gjykata kompetente që do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të këshillave për marrjen e masave disiplinore ndaj magjistratëve gjatë gjithë mandatit të tij 9- (nëntë) vjeçar, duke përfshirë këtu të gjitha llojet e masave disiplinore të parashikuara nga neni 105 i ligjit nr. 96/2016.

3.2.9 Në vijim të arsytimit, Gjykata Kushtetuese/Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka kompetencë të parashikuar në ligj të shqyrtojë ankimet e magjistratëve ndaj akteve të tjera individuale që nxjerrin këshillat që nuk përbëjnë masë disiplinore. Në këtë këndvështrim, pezullimi i detyruar, duke mos qenë një masë disiplinore, për argumentet e dhëna më sipër, nuk është në asnjë rast një akt i cili mund të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese/Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

3.2.10 Në zbatim të nenit 155, të ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon - “*Vendimi për pezullimin nga detyra, sipas parashikimit të neneve 151 dhe 152, të këtij ligji, merret nga Këshilli brenda tri ditëve pas paraqitjes së kërkesës ose informacionit.*

2. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në gjykatën kompetente.

3. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vendimin për pezullimin nga detyra të magjistratit” - natyrshëm që magjistratit i garantohet e drejta e ankimit ndaj një vendimmarrjeje të tillë, por gjykata kompetente në këtë rast nuk është Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

Në nenin 184/1, germa “e” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë” parashikohet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës, ndër të tjera, *për vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin* në lidhje me prokurorët, duke e trajtuar këtë funksion si një veprim që lidhet me karrierën dhe disiplinën, si elemente të statusit të magjistratit.

Në nenin 189/1, germa “a” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikohet se këshilli, në ushtrim të funksioneve të tij, nxjerr akte individuale që lidhen me statusin profesional të prokurorëve të veçantë.

3.2.11 Në analizë të këtyre parashikimeve, Kolegji çmon se urdhrat e nxjerrë për pezullimin e detyruar të prokurorëve, janë akte administrative individuale në kuptim të neneve të mësipërme të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Duke iu rikthyer parashikimit të nenit 192/1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Kolegji çmon se me gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankimit ndaj këtyre akteve individuale, duhet të kuptohet Gjykata e Apelit Administrativ, në të cilën ankimohen vendimet e këshillave që janë akte administrative për shkak të pasojave që prodhojnë për magjistratët, akte që nuk janë masa disiplinore. Në këtë kategori, në vlerësimin e Kolegjit, duhet të përfshihet edhe akti i pezullimit nga detyra si një pezullim i detyruar, objekt ankimi, i nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm.

3.2.12 Për sa më lart, Kolegji çmon se, në verifikim të kriterëve të parashikuara nga neni 31/a, paragrafi 2 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese*” i ndryshuar i cili parashikon se:

“a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të kriterit referues të parashikuar nga neni 71/a, paragrafi 2 i të njëjtit ligj, i cili parashikon se:

“1. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

a) kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion;

b) kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit;

c) pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin;

ç) shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.

2. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, gjejnë zbatim rregullimet e parashikuara në këtë ligj për shqyrtimin paraprak”.

- 3.2.13 Ankimi ndaj urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm të numërtuar me numrat 140 dhe 141, datë 11.05.2018, nuk është në kompetencën e shqyrtimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Parashikimi që bëhet në këta urdhra për sa i përket së drejtës së ankimit të prokurorëve, nuk është detyrues për gjykatën e cila në përcaktimin e kompetencës ose moskompetencës së saj, lidhet dhe detyrohet vetëm nga përcaktimet që bën ligji dhe jo nga ato që bëjnë në akte institucione të ndryshme në ushtrim të funksioneve të tyre vendimmarrëse.
- 3.2.14 Bazuar në sa parashtruar dhe referuar me sipër, Kolegji çmon se shqyrtimi i ankimit të bërë nga ankuesit Rovena Gashi dhe Dritan Gina me objekt anulimin si të paligjshëm të vendimeve nr. 140 dhe nr. 141, datë 11.05.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm – duke qenë se nuk janë akte administrative individuale që vendosin masa disiplinore në kuadër të një procedimi disiplinor, në referim të nenit 5, pika 3 e ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 31/a “Moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare” i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i ndryshuar – nuk duhet të kryhet nga kjo gjykatë. Për këto shkaqe, Kolegji duhet të vendosë për moskalimin e çështjes në seancë plenare pasi kërkimet e parashikuara në ankimim nuk hyjnë në kompetencën (*ratione materiae*) e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i shqyrtimit paraprak të ankimit, bazuar në nenin 31, neni 31/a paragrafi 2 germa “a”, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 21.06.2018.

GJYQTAR

Luan DACI
(D.V)

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ
(D.V)

GJYQTARE

Ina RAMA
(D.V)